



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### V E N D I M

Nr. 327, datë 17.09.2020

#### PËR

### VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 84 DATË 26.02.2020 DHE NR. 245 DATË 09.07.2020 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 17.09.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

#### V Ë R E N

#### I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 84, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.*

...

*3. Afati i kandidimit është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

2. Vendimi i Këshillit si më lart për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020, duke përfunduar ky afat në datë 30.07.2020.

3. Me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, Këshilli ka vendosur :

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.*

...

*3. Afati i kandidimit është deri më datë 30.07.2020”.*

4. Vendimi i Këshillit sipas pikës 3 për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 09.07.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 10.07.2020.

5. Brenda afateve të kandidimit për dy pozicionet e lira si më lart, pra atë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

*“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...*

*1. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; ...”.*

7. Më datë 07.08.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtari tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Po të njëjtën datë, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, referuar disponimit të pikës 4, të Vendimit të Këshillit nr. 268, datë 07.08.2020, meqënëse procedura e verifikimit të kritereve të pasurisë dhe figurës për këtë kandidate është në proces përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ndërkohë që kjo procedurë është përcaktuar nga Këshilli si

e vlefshme edhe për procedurën e ngritjes në detyrë të kandidatës edhe në Gjykatën e Lartë, në rrugë elektronike, kandidatës iu dërguan vetëm dy nga deklaratat dhe autorizimet sipas pikës 6, të këtij seksioni dhe kreu, të Vendimit 75/2019, konkretisht Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, meqënëse verifikimi në lidhje me disa kritere përfshin një gjykatë të ndryshme nga ajo mbi të cilën është kryer verifikimi i mëparshëm.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ç’ka nënkupton të drejtën e Këshillit për të vijuar verifikimin me kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

11. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

12. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

12.1 Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 3189/1 prot., datë 13.07.2020, ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

12.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht sa i përket “përvojës specifike profesionale” të kandidatës në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, konkretisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë prej datës 04.11.2013, u vlerësua i panevojshëm kërkimi i informacionit nga kjo gjykatë, ndërsa është e qartë përvoja e kandidatës në këtë fushë të së drejtës.

## II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

### 13. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i *“përvojës profesionale minimale”*.

14. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 136, pika 3 (fjalë e parë), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”*. Ndërkohë, “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet dhe në nenin 47, pika 5, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*.

15. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, pra jo më pak se trembëdhjetë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës administrative për dy pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020.

16. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007. Kandidatja ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet 2006-2007 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku ka ushtruar funksionin për periudhën 14.11.2007 – 04.11.2013. Nga data 04.11.2013, ajo ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

17. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5045 datë 04.10.2006, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5515 datë 14.11.2007, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8247 datë 16.07.2013, dekret i cili ka hyrë në fuqi me datën 04.11.2013, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku vijon të ushtrrojë funksionin dhe aktualisht.

**18. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, rezulton të ketë mbi trembëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.**

19. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi të kandidates si dhe referuar të dhënave, rezulton se kandidatja znj. {...}, nga data 04.11.2013 dhe në vijim, është gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e për rrjedhojë që nga kjo datë ajo gjykon vetëm çështje me lëndë administrative.

**20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative.**

**21. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

22. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

23. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 28.07.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

24. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

**25. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.**

**26. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.**

27. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cënuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë*”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “*Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë*”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “*Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni*”.

28. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 28.07.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

29. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

**30. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.**

### **III. KONKLUZIONE**

31. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245 datë 09.07.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

32. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245 datë 09.07.2020.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 84 datë 26.02.2020 e nr. 245 datë 09.07.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

**VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në fushën e të drejtës administrative për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në fushën e të drejtës administrative për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**